



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR DATË
25.06.2025

Me datë 25.06.2025, u mbajt mbledhja e Këshillit Bashkiak Shkodër. Këshilltarë të pranishëm ishin: Oltion Luli, Edmond Ndou, Jona Leqejza, Bledianë Nika, Uarda Gjekaj, Hilmi Lakti, Fatbardh Dama, Vjollca Petani, Erald Erkocaj, Armela Brahimi, Mirsad Bashi, Ardit Taflaj, Hedije Nasa, Gëzim Galiqi, Alma Mehmetaj, Erlinda Kavaja, Taulant Shahmani, Jurgena Bracaj, Gjovalin Ndoj, Joniz Osmanagaj, Irena Shala, Irma Kopliku, Valjeta Bajraktari, Eliona Shkrela, Ardit Behri, Glorja Shllaku, Gjergj Sokoli, Rezarte Pode, Lulash Nika, Ervin Brahimi, Vjoleta Perndrecaj, Ardita Spahija, Samed Bushati, Suada Kopshti, Fatmir Vojvoda, Plarent Anamali, Muharrem Shkjau, Amila Lici.

Mbledhja hapet nga Kryetari i Këshillit **Z.Oltion Luli**
Rendi i ditës së mbledhjes është si vijon:

1. *Pr/Vendim: "Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Maj 2025".*
2. *Projektvendim: "Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar".*
3. *Projektvendim: "Për një ndryshim në VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar".*
4. *Projektvendim: "Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër".*
5. *Projektvendim: "Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Shkodër".*

6. *Projektvendim: "Për një shtesë dhe ndryshim në VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar".*
7. *Projektvendim: "Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri".*
8. *Projektvendim: "Për miratimin e kriterëve dhe për caktimin e rrugëve dhe shesheve publike për administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në Velipojë dhe Shirokë, të Bashkisë Shkodër".*
9. *Projektvendim: "Për miratimin e rrjetit të linjave, stacioneve të qëndrimit dhe të tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë Shkodër".*
10. *Projektvendim: "Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër".*
11. *Diskutime jashtë rendit të ditës.*

Kourumi i domosdoshëm është present në salla, mbledhja deklarohet e hapur.

Z.Luli fillon leximin e rendit të ditës.

Ndërhyn **Znj.Shala**, e cila për procedurë shprehet se nisur nga fakti që po kërkohet një rialokim fondi në një vlerë të madhe, pa kaluar në këshillim me qytetarët dhe sipas nenit 54 dhe 18 të ligjit 139 për vetëqeverisjen vendore nuk lejohet që të kalohen në këshill të tillë project vendime pa dëgjuesë publike, prandaj Znj.Shala në emër të grupit të BF-së, kërkon heqjen e pikës 6. nga rendi i ditës.

Z.Luli vijon me leximin e rendit të ditës dhe përpara se të hidhet në votim, znj.Shala ka të njëjtin propozim, heqjen e pikës 6 nga rendi i ditës.

Fjalën e merr **Z. Ndou**, i cili thotë se për shkak të kohës dhe diskutimeve që mund të marrin dy nga projekt vendimet, konkretisht pika 4 dhe 5, ai propozon që këto pika të kalojnë për miratim në fund të rendit.

Sipas rregullores **Z.Luli** shprehet se sipas rregullores të dy propozimet do hidhen në votim.

Ndërhyn përsëri **Znj.Shala**, e cila thotë se nuk ka nevojë të hidhet në votim, pasi ajo çka kërkoi ajo, bie ndesh me ligjin 139, nenin 54 dhe nenin 18.

Z.Gj.Sokoli shprehet se a mund të kemi një sqarim për çfarë pretendon Znj.Shala nga drejtoria juridike?

Z.Luli sqaron se rendi i ditës është vendosur në mbledhjen e kryesisë së Këshillit, pjesë e së cilës ka qënë edhe Znj.Shala nuk ka patur asnjë kërkesë të tillë. Për më tepër që është vetë Këshilli që vendos të hiqet apo jo një pikë nga rendi i ditës.

Ndërhyn **Znj.Shkrela** duke thënë se Këshilli bashkiak funksionon sipas ligjit dhe duhet të kishte dëgjuesë publike për pikën 6. të rendit të ditës.

Përsëri **Z.Luli** thotë se mbi bazën e ligjit propozimi do hidhet në votim.

Znj.Shllaku i drejtohet kryetarit të Këshillit, duke i thënë se kjo është shkelje ligjore.... Dhe duhet të ishit ju, që duhet ta kishit në vëmendje dhe të mos ta sillnit në Këshill për miratim.

Z.Luli përgjigjet duke thënë se ju keni forma të tjera ligjore për ta ndjekur këtë çështje nëse e shihni në këtë mënyrë, unë do ta hedh në votim sipas procedurës së përherëshme, që në Këshill vendoset heqja e pikave të rendit të ditës me votë.

Përsëri **Znj.Shala** merr fjalën dhe pyet se cila është emergjenca që një projekt vendim të kalohet pa dëgjuesë, në një rast që bëhet fjalë për një shumë të madhe që kalon në buxhetin e Bashkisë?

Z.Luli përsëri pyet nëse është lexuar materiali , dhe a e dini se përse bëhet fjalë në këtë pr/vendim?

Znj.Shala, po e kemi lexuar, por kërkojmë të dimë pse kjo urgjencë për këtë, kur kemi vërejtur shkelje?

Edhe njëherë **Z.Luli** shprehet se ju keni të drejtë ta monitoroni dhe ta ndiqni më tej, pas miratimit të kësaj pr/vendim.

Hidhet në votim propozimi për heqjen e pikës 6. nga rendi i ditës, ku rezultojnë **10** vota Pro **25** Kundër **0** Abstenim. **Nuk Miratohet**

Vijohet po ashtu me votimin e propozimit të Z.Ndou për kalimin e pikës 4 dhe 5 në fund të rendit të ditës....

Ndërhyn **Znj.Bajraktari** e cila kërkon të dijë se për çfarë arsyeje duhet të bëhet ky ndryshim, pasi kohën e merr një soj si në fillim ashtu edhe në fund.

Z.Luli citon këtu rregulloren e Këshillit bashkiak, e cila thotë se çdo Këshilltar ka të drejtë të propozojë ndryshim të rendit të ditës dhe me votë të miratohet ose jo një gjë e tillë.

Z.Osmanagaj thotë se pse nuk u lexua rregullorja ose ligji për propozimin tonë. Kjo nuk është aspak korrekte.

Z.Luli shprehet se po ndiqet e njëjta procedurë, po hidhen në votim të dy propozimet dhe vendoset me votë për to.

Znj.Shala përsërit se duhet të ishte lexuar për transparencë për qytetarët neni 54 dhe 18 i ligjit 139 për vetëqeverisjen vendore dhe të sqarohet se pse po kalojnë 3 miliardë lekë shtesë në buxhet pa dëgjuesë publike.

Z.Luli sqaron përsëri se ne nuk po ndryshojmë buxhetin por po miratojmë financime shtesë.

Hidhet në votim propozimi i Z.Ndou, ku rezultojnë **29** vota Pro **8** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 1. të rendit të ditës: *Pr/ Vendim: “Për përdorimin e fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike (deri në 6%) për muajin Maj 2024”.*

Siç është rënë dakord ky pr/akt s’ka nevojë për relativ prandaj kalohet në votimin e kësaj pike, ku rezultojnë **38** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 2. të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për një shtesë në buxhetin e vitit 2025 e miratuar VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”.*

Relaton për këtë pikë **Zv/ Kryetari Z.Beka**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj. Bajraktari shpreh dakordësinë për rritjen e numrit të punonjësve të MZSH-së, për më tepër në këtë periudhë por shton se ka një pyetje: Në buxhetin që është miratuar në dhjetor 2024, ka qënë e pasqyruar transfertat sektoriale për pagesën e këtyre punonjësve, që po kërkohen të shtohen sot. A mund të dimë se ku kanë shkuar këto para për këto muaj, që nuk kanë qënë këto punonjës që po shtohen tani?

Përgjigjet **Znj.Haxhi**, buxheti që vjen për MZSH është transfertë sektoriale dhe ne nuk kemi të drejtë ta përdorim për asgjë tjetër. Ai fond nuk është përdorur askund por është lënë në gjendje për pagat. Pastaj për arsye fushate zgjedhore nuk mund të kishte punësime të reja. Ai fond është gjendje, pasi nuk kemi të drejtë ta kalojmë nga një program në një tjetër, është transfertë sektoriale me destinacion.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen Pro.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **36** vota Pro **0** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Përpara se të kalohet tek pika e radhës së rendit të ditës, kërkohet nga kryetari i Këshillit miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të Këshillit Bashkiak, sipas ligjit Nr.8480 datë, 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, neni 16 pika 2, ku rezultojnë **34** vota Pro **0** Kundër **2** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika tjetër: *Projektvendim: “Për një ndryshim në VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”.*

Relaton përsëri **Zv/ Kryetari Z.Beka**, sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Bajraktari shprehet se rritja e punonjësve duhet të ishte parashikuar në buxhet aq më tepër tani pas zgjedhjeve nuk është aspak korrekte. Ajo shton se ka dy pyetje: Janë shtuar 10 punonjës me kontratë për menaxhimin e ujitjes dhe vjeljes së taririfës.

Sqaron **Z.Mema**, drejtor i përgjithshëm i drejtorisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik, duke thënë se duke patur parasysh investimet në zonë, ka nevojë për punonjës shtesë për mirëmenaxhimin e tyre nga ana teknike.

Për më tepër detaje sqaron edhe **Z.Salihi**, drejtor i ndërmarrjes së shërbimeve publike.

Vijon **Znj.Bajraktari** duke thënë se edhe tek drejtoria e arsimit po kërkohen 5 punonjës shtesë, në një kohë që para pak kohësh u bë shkurtim me arsyetimin se nuk kishim nevojë. Tani pas miratimit të buxhetit kërkojmë 5 punonjës shtesë. Ajo shton se në parim është dakort sepse arsimi ka nevojë por pse pas strukturave që u bënë? Edhe tek drejtoria e mirëmbajtjes së objekteve publike kemi një shtesë prej 5 vetash, por nuk dimë se cilat do jenë detyrat e tyre funksionale. A mund të kemi më shumë informacion?

Përgjigjet **Z.Beka** për këtë duke thënë se me marrjen e detyrës, vërejtëm se kishte patur punësime me nepotizëm dhe fryrje të stafit. Kurse tani po kërkojmë përmirësim të shërbimit në të gjithë sektorët.

Për më tepër sqarim flet edhe **Z.Kullaj**, drejtor i ndërmarrjes së mirëmbajtjes së objekteve publike.

Znj.Shllaku shprehet se është dakort që të shtohen punonjës ku është e nevojshme, por si për koincidençë sot takova një zotëri që ishte hequr nga puna dhe ishte i keqardhur që këto drejtues që janë tani përveç se janë të paafte, krijojnë edhe presion tek punonjësit. Ajo pyet meqënëse ka shtesë punonjësish, a ka kosto të parashikuar për to dhe sa është ajo për buxhetin vendor?

Përgjigjet **Znj.Haxhi**: Efekti financiar është 11.04 milion lekë, kurse sigurimet janë 1.8 milion lekë.

Znj.Petani replikon duke thënë se nuk e kuptoj se për çfarë presioni po flitet. Paskeni harruar se kur ju drejtonit Bashkinë kishte tamam presion.

Znj.Shkrela shprehet se së pari nuk është aspak serioze mosprezenca e kryetari të Bashkisë në mbledhje. Ai ka qënë present vetëm një herë si i deleguar politik kur hapi fushtën dhe u largua se nuk e përballoi t'i përgjigjej pyetjeve tona. Kërkojmë që ait ë jetë prezent dhe të përgjigjet sepse është detyrim ligjor dhe moral ndaj qytetarëve, kurse përsa i përket punësimeve, shton ajo sapo

kryetari mori detyrën, bëri revolucion duke hequr nga puna pafund punonjës dhe tani çdo 2-3 mbledhje kërkon punësime të reja, pse i ka hequr atëherë ? Apo tani njërezit e tij, që i kanë bërë fushatën duhet të sistemohen? Administrata po fryhet kështu edhe më shumë seç ka qënë më parë. Prandaj do ishte mirë që më parë të merresh në punë ato persona që janë shkarkuar, pastaj të kërkoheshin punonjës të ri, vetëm e vetëm në shërbim të tij. Ajo gjithashtu thotë se pjesa më e madhe e buxhetit shkon për paga, ndërkohë që qyteti ka plot nevoja të tjera.

Vijohet me replika mes **Znj.Petani** dhe **Znj.Shkrela**.

Znj.Kavaja shprehet se do dëshironte të kishte një debat më me nivel dhe me argumenta. Dhe do ishte mirë të lexonim njëherë materialin e paraqitur për të kuptuar që kërkohej punonjës shërbimi dhe nuk flitet për poste drejtorësh siç po pretendohet.

Znj.Mehmetaj në lidhje me pr/vendimin shprehet se duhen lexuar me një vision më të hapur sepse punonjësit që po kërkohej janë sezonal dhe nuk bëhet fjalë për të fryrë administratën. Cdo gjë bëhet në bazë të nevojave dhe shërbimit më të mirë për qytetarët.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehen Pro.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **30** vota Pro **1** Kundër **7** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me Projektvendimin: *“Për një shtesë dhe ndryshim në VKB-në nr.76 datë 19.12.2024 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2025 dhe programit buxhetor afatmesëm përfundimtar 2025-2027 të Bashkisë Shkodër, i ndryshuar”.*

Relaton **Z.Mema**, drejtor i përgjithshëm i drejtorisë së Zhvillimit të Qëndrueshëm Ekonomik. Në mënyrë analitike flet edhe Zv.Kryetari Beka. Po ashtu për një pjesë të këtij projekt akti sqaron edhe Z.Salihi.

Znj.Bajraktari thotë se ky rialokim vjen nga shtesa e të ardhurave që ka Bashkia si dhe nga pjesa e papërdorur nga viti i kaluar. Në materialin e paraqitur kemi mospërputhje shifrash. A mund të dimë cila është shifra e saktë, ku është diferenca?

Përgjigjet **Znj.Haxhi** se një gjë e tillë u sqarua edhe në mbledhjen e komisionit të buxhetit dhe çdo gjë është e akorduar me degën e thesarit. Cdo gjë është e verifikueshme me dokumentacion.

Vijon **Znj.Bajraktari**, në tabelën e realizimit të buxhetit 2024 tek shpenzimet operative shohim se ka një gjendje prej 229.5 milion lekë, ndërkohë po rialokohen 160.8 milion. Pse nuk është bërë shpërndarja e krejt fondit dhe a do ketë rialokime të tjera? E njëjta gjë vlen edhe për investimet.

Përsëri **Znj.Haxhi** thotë se rialokimi zgjat gjithë vitin deri me datë 15 nëntor sipas ligjit dhe deri atëherë kemi mundësi për rialokime të tjera.

Tjetër pyetje nga **Znj.Bajraktari** lidhet me vleren e 34 milion lekë për ndërtimin e shtëpizave dhe me llogaritje del që një shtëpi do kushtojë 1.7 milion. Sa do jenë përmasat e shtëpizave që do blihen dhe menaxhimi i tyre do bëhet nga Bashkia apo nga “Skodrinon”? Sa do jetë qiraja për to, a do mund të merren shtëpiza të tjera për aktivitete?

Z.Luli thotë se këto do jenë specifikime tenderash, nuk i takon Këshillit të merret me këto...

Përgjigjet **Znj.Smaja**, e cila shprehet se u përgjigj kësaj pyetjeje edhe në mbledhjen e komisionit. Ne kemi marr ofertë për ndërtimin e shtëpizave, megjithatë kuptohet se me tenderim do bëhet studimi i tregut dhe do fitojë oferta më e mirë. Po ashtu më detajisht dhe teknikisht sqaron edhe **Z.Salihi** për këtë.

Po ashtu shton **Znj. Smaja** se menaxhimi do bëhet nga Bashkia, pasi kemi plot aktivitete që Bashkia organizon.

Znj.Shkrela në lidhje me shtëpizat shprehet se i duket nonsens të blihen shtëpiza për një muaj, ndërkohë që kemi pak ditë që janë djegur disa banesa të komunitetit Rom. Ajo mendon që më mirë do ishte që ato lekë të përdreshin për sistemimin e tyre. Tek e fundit shtëpizat kanë qënë aty, me qera apo jo dhe nuk ka nevojë të merren përsëri para nga taksat e qytetarëve për to, kur një komunitet është në qiell të hapur. Ajo shton se tashmë kemi miratuar fonde për aktivitete pse vazhdohet të kërkohen shtim fond për to?

Për më tepër ajo kërkon të dijë më shumë edhe për zyrën e re të informacionit turistik. Pretendohet për imazh, turizëm etj. Nuk e kuptoj thotë ajo pse duhet të shpenzohen 85 milion lekë në një godinë, kur në fakt ka probleme shumë të mëdhaja me turizmin. Më mirë do ishte të kërkoheshin projekte efikase dhe restaurim banesash që rezikojnë shembjen, pastrim dhe rregullim pllakash.

Znj.Petani shprehet se nuk i duket e arsyeshme që të thuhet se nuk po punohet. Puna që po bëhet në Shkodër është e mëse e dukshme nga të gjithë.

Znj. Bajraktari thotë se nuk është e nevojshme që për çdo diskutim tonin të thuhet pse nuk e keni bërë ju e të bëhen krahasime. Jemi këtu për të diskutuar dhe jo të bëjmë komente të kota.

Po ashtu edhe **Z.Sokoli** i kërkon **Z.Luli** që të mos lejojë që kolegët këshilltarë të kalojnë në debate të tejzgjatura me replika të kota.

Znj.Leqeja shprehet se është dakort me kolegët parafolës, që po zgjatemi në debate të pavlera. Ajo shton se duke qënë se ka qënë anëtare edhe më parë, asnjëherë nuk ka patur pretendime për dëgjesa për Pr/vendime për rialokime, përkundrazi vullneti i të majtëve ka qënë shumë i madh për ta miratuar propozimin e ekzekutivit të asaj kohe. Ne si këshilltarë me bonsens jemi këtu për të

diskutuar përparësitë që mendojmë se duhen të çohen përpara nga ekzekutivi duke përcjellë edhe zërin e qytetarëve.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou dhe Z. Sokoli shprehen Pro, kurse Z.Osmanagaj nga grupi i BF-së janë kundër për arsyet e sipërpërmendura.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **28** vota Pro **6** Kundër **1** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën e rradhës: *Projektvendim: “Mbi dhënien e ndihmës financiare për dëmet e shkaktuara nga zjarri”.*

Znj.Pode propozon që kjo pikë të mos relatohet.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika tjetër e rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin e kriterëve dhe për caktimin e rrugëve dhe shesheve publike për administrimin e shërbimit të parkimit me pagesë në Velipojë dhe Shirokë, të Bashkisë Shkodër”.*

Relaton për këtë pr/vendim **Zv/Kryetari Z.Preka** sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou dhe Z. Sokoli shprehen Pro, kurse Z.Osmanagaj nga grupi i BF-së shprehet kundër me arsyetimin se këto janë parkingje të ndërtuara nga Bashkia dhe nuk ka pse të ketë pagesa.

Z.Preka sqaron se tarifimi do bëhet nga Bashkia dhe nuk do jepet me qira.

Znj.Shkrela ndërhyr dhe thotë se duhet të lihen pa pagesë parkingjet publike...

Z.Preka përsëri, sqaron duke thënë se nuk mund të lejojmë që një qytetar uzurpues i një vendparkimi pa kriter të veprojë sipas dëshirës. Kjo bëhet edhe për të rregulluar qarkullimin e automjeteve. Jemi edhe para faktit që kemi numër të limituar të vendparkimeve.

Vijon **Znj.Shkrela** duke thënë se a mendoni ndonjëherë për të mirën e qytetarëve sepse vetëm taksa, gjoba, tarifime në një kohë që Shkodra është qyteti më i varfër dhe ku po shkojnë këto taksa??? Për paga punonjësish?

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **28** vota Pro **6** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me pikën 9. të rendit të ditës: *Projektvendim: “Për miratimin e rrjetit të linjave, stacioneve të qëndrimit dhe të tarifës së biletave të transportit qytetës dhe rrethqytetës të udhëtarëve në Bashkinë Shkodër”.*

Relaton për këtë pr/vendim **Znj.Kuçi**, specialiste transporti pranë drejtorisë së të ardhurave sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Fjalën e merr **Znj.Pode** , e cila rekomandon të rishihen oraret e veprimeve që do kryhen nga mjetet e vendosura në dispozicion, sidomos oraret të jenë më të hershme, po ashtu edhe orari I fundit të shtyhet.

Z.Sokoli kërkon të dijë nëse ka ndryshim vendqëndrimesh për automjetet apo do jenë ato ekzistueset?

Përgjigjet **Znj.Kuçi** duke thënë se nuk do ketë ndryshime të mëdha për këtë.

Për më tepër sqaron **Z.Kurti** duke thënë se ka ndryshime për transportin ndërqytetas, për linjën e Dajçit, Ana malit, Trushit për arsye punimesh dhe korsive të biçikletave.Gjithashtu ka propozime edhe për linjën e Velipojës që të spostohet në blvd. “Bujar Bishanaku”. Për linjat e tjera nuk do ketë ndryshime.

Z.Sokoli flet në emër të grupit PSD duke thënë se është dakort për linjat që u cituan përveç asj të Velipojës me arsyetimin se si pikë turistike duhet t’I jepet përparësi. Për më tepër dëmton edhe qytetarët.

Z.Luli sqaron se ndryshimet e pr/vendimeve nuk mund të bëhen në seancë. Këto duhet të ishin diskutuar në komisione.

Znj.Shllaku kërkon që të saktësohet vendqëndrimi I mjeteve në fjalë. Duhet të ishte menduar edhe për turistët, të cilët nuk dinë të orientohen me këto linja.

Znj.Shkrela shprehet se është dakort me kolegun Sokoli përse I përket linjës së Velipojës. Ajo duhet të rishikohet sepse në fokus është turizmi. Madje ka edhe një kërkesë nga shoferët e linjës së Velipojës për të qëndruar në të njëjtin vend.

Nga ana e administratës përgjigjet **Z.Lulzim Mashi**, duke iu referuar edhe mobilitetit, është parë e arsyeshme edhe shmangia e këtyre pikave për shkak të trafikut, sidomos në sezon.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou shprehet Pro, edhe Z. Sokoli shprehet Pro, por kërkon rishikimin e linjës së Velipojës.

Po ashtu edhe Znj.Shkrela shpreh dakordësi me përjashtim të linjës së Velipojës.

Z.Luli edhe njëherë shprehet se nuk mund të ndryshohen në seancë Pr/vendimet.

Z.Shkjau thotë se faktikisht specialist e sqaroi shumë mirë dhe mendon që është e drejtë që të gjitha linjat të jenë të grumbulluara në një vend afër unazës.

Z.Osmanagaj shprehet se ato si grup janë kundër pr/aktit.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **21** vota Pro **6** Kundër **8** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet tek pika e rradhës: *Projektvendim: “Për miratimin e rregullores së përdorimit të hapësirës publike në Bashkinë Shkodër”*.

Propozohet që kjo pikë të mos relatohet , pasi tashmë të gjithë janë njohur me materialin në fjalë.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku të gjithë shprehin dakordësi.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **35** vota Pro **0** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Vijohet me: *Projektvendim: “Për miratimin e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të vitit 2024 të Bashkisë Shkodër”*.

Relaton për këtë pr/vendim **Znj. Haxhi** sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Znj.Bajraktari propozon që të kalohet direct tek pyetjet dhe diskutimet. Ajo kërkon të dijë se sa është vlera e varkave të dhuruara nga Fondi i Zhvillimit, pasi për këto varka ka patur një tender ndërkombëtar për blerje dhe transport. Gjithashtu Fondi i Zhvillimit ka investuar në fasada dhe shtresa asfaltike dhe këto shuma nuk janë të pasqyruara. Ajanë marr në dorëzim këto punime që janë bërë?

Përgjigjet **Znj.Haxhi** duke shoqeruar me materialin. Ajo sqaron se çdo gjë është lehtësisht e verifikueshme me dokumentacion.

Z.Galiqi, kërkon të dijë si është realizuar buxheti 2024 në përqindje totale dhe së dyti cilat kanë qënë vështërsitë që keni patur për realizimin e tij?

Përsëri **Znj.Haxhi** sqaron se për këtë është folur në mbledhjen e kaluar, por vlen të theksohet shton ajo se pozitiv është fakti se burimi i rialokimit 68 milion ishte si rrjedhojë e realizimit në masën 107% të të ardhurave. Është hera e parë që BASHkia ka realizim mbi planin.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku Z.Ndou dhe Z. Sokoli shprehën Pro, kurse Z.Osmanagaj nga grupi i BF-së është kundër.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **24** vota Pro **3** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kalohet në pikën e fundit: *Projektvendim: “Për miratimin e projektit të parë të programit buxhetor afatmesëm 2026-2028 për Bashkinë Shkodër”*.

Fillon relatimin për këtë pr/vendim **Znj. Haxhi** sipas materialit të përgatitur nga administrata.

Nga ana e **Z.Sokoli** propozohet që të kalohet në votim pasi jemi njohur të gjithë me materialin.

Znj.Leqejza shprehet se ajo mendon se për interesin e qytetarëve do ishte mirë që të vijohej me sqarimet mbi pr/aktin dhe most ë procedohet me dy standarte për performance personale, duke parë e analizuar detaje të parëndësishme.

Z.Osmanagaj dhe **Znj.Shllaku** shprehen se **Znj.Haxhi** mund të vazhdojë me relatimin pasi për buxhetin ka gjithmonë interes.

Vijon analizën e detajuar **Znj.Haxhi**.

Kalohet tek mendimi i kryetarëve të grupeve, ku **Z.Ndou** dhe **Z. Sokoli** shprehen Pro, kurse **Z.Osmanagaj** nga grupi i BF-së është kundër.

Hidhet në votim pr/akti, ku rezultojnë **26** vota Pro **4** Kundër **0** Abstenim. **Miratohet**

Kolohet në diskutime jashtë rendit të ditës.

Fjalën e merr **Znj.Pode** , e cila sjell një shqetësim qytetar për rrugën Ura e Mesit/Mes/Meselim që kërkon ndërhyrje urgjente për shtrim me asfalt.

Z.Sokoli thotë se janë plotësisht dakort me punët dhe investimet qe shteti ka bërë në Bashkinë Shkodër por ai shprehet se jemi shumë larg me projektet e Buxhetit 2025. Ai sjell në vëmendje rastin e rrugës Roza Lejn, në të cilën nuk është ndërhyrë akoma. Gjithashtu sjell një shqetësim të banorëve të fshatit Juban, në lidhje me kanalet vaditëse.

Përgjigjet **Z.Mema** duke thënë se jemi në fazat përfundimtare për të marr përgjigjen nga ana e Ministrisë, pasi nuk mund të fillojmë me tender pa ardhur shkresa nga ministrua. Nuk ka vonesa në projektim , jemi gati sapo të marrim miratimin.

Z.Behri, pyet nëse është e mundur të ndërhyhet në rrugën 8, në Velipojë, ku është edhe frekuentimi më i madh i turistëve. Ka problematika me ujësjellësin dhe me në disa pika të rrugës. Ai shton po ashtu nëse është e mundur të bëhen edhe aktivitete të ndryshme në Velipojë që t'i japim më shumë promovim.

Përgjigjet **Z.Beka** duke thënë se do ketë aktivitete sportive dhe po ashtu po planifikojmë edhe evente muzikore sidomos në pikun e sezonit. Për ndërhyrjet që u kërkuan është mbajtur çdo gjë shënim nga ana jonë.

Znj.Pode përsëri shpreh një tjetër shqetësim në lidhje me parkingjet me pagesë të bizneseve, të cilët edhe pse paguajnë me orare të caktuara vazhdojnë të bllokojnë vendparkimet edhe jashtë këtyre orareve. Duhet të merren masa nga Policia Bashkiake që ti lihet vend edhe qytetarëve.

Znj.Shllaku shprehet se duhen marr masa në lidhje me fasadat në zonën e Gjuhadolit, pasi aty biznese vendosin tavolina dhe qytetarët mund të jenë të rrezikuar ne çdo moment. Po ashtu shqetësim tjetër është edhe fakti që shumë biznese paguajnë taksa dhe tarifa shërbimi ndërkohë që “cënohen” nga shitësit ambulantë. A janë marr masa për këtë nga Bashkia?

Përgjigjet për këtë **Z.Rustemi**, drejtor i Policisë Bashkiake duke thënë se do bëhen verifikime në Gjuhadol dhe do merren masa për çdo rast.

Z.Taflaj sjell në vëmendje shqetësimin e tij të hershëm për gjendjen e pallatit të sportit dhe përgëzon Bashkinë për ndërhyrjen dhe punën që po bën aty.

Znj.Shkrela thotë nëse është e mundur të bëhet pastrimi dhe larja e pedonales në Gjuhadol dhe pjesa para Katadrales dhe gjithashtu të paktën një herë në muaj të lahet pedonalja kryesore. Tjetër shqetësim është edhe i një grup banorësh i lagjes “Skenderbeg” në lidhje me vendqëndrimein e makinave të mbeturinave, të cilat mbajnë erë të rëndë, sa banorët aty nuk mund të hapin as dyer e as dritare. A është e mundur të bëhet larja e tyre dhe dezinfektimi.

Z.Beka shprehet se të dyja kërkesat janë të realizueshme. Do bëhet larja e pedonaleve dhe gjithashtu do kontaktohet firma përsa i përket makinave të mbeturinave.

Pyetje e diskutime të tjera nuk ka.

*Kryetari e Këshillit **Z.Luli** e deklaron mbledhjen të mbyllur.*

Procesverbali, pasqyron në mënyrë të përmbledhur diskutimet e mbledhjes së Këshillit Bashkiak Shkodër të datës 25.06.2025. Bashkëlidhur këtij procesverbali, materiali i mbledhjes Audio.(DVD).

Procesverbali përmban 13 faqe dhe pasi lexohet, nënshkruhet pa vërejtje nga:

V.o: Ky procesverbal do miratohet nga anëtarët e Këshillit në mbledhjen e radhës së Këshillit bashkiak.

Sekretar

Sabina DANAJ



Zbardhi Pr/verbalin:

Irma Sulishti

A handwritten signature in blue ink, appearing to read 'Irma Sulishti', is written over the printed name.